

VENDIM
Nr. 594, datë 18.10.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKUALIFIKIMI I HAPËSIRAVE PËRRETH PALLATIT TË KULTURËS, RRUGA ME
TRAFIK TË KUFIZUAR/ PEDONALJA “PASHO HYSI”, RRUGA AUTOMOBILISTIKE
“PASHO HYSI””,
NË BASHKINË E SKRAPARIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i hapësirave përreth Pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja “Pasho Hysi”, rruga auto-mobilistike “Pasho Hysi””, në Bashkinë e Skraparit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Skraparit.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “ndërtesë”, me sipërfaqe 15 (pesëmbëdhjetë) m², me vlerë të përgjithshme prej 653 703 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 653 703 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatë-qind e tre) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Skraparit, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Skraparit.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Skraparit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë “ndërtesë”, me sipërfaqe 15 (pesëmbëdhjetë) m², për projektin “Rikualifikimi i hapësirave përreth Pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja “Pasho Hysi”, rruga automobilistike “Pasho Hysi””, të bëhet në favor të Bashkisë së Skraparit.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Skrapar dhe Bashkia e Skraparit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR
REALIZIMIN E PROJEKTTIT “RIKUALIFIKIM I HAPËSIRAVE PËRRETH PALLATIT TË
KULTURËS, RRUGA ME TRAFIK TË KUFIZUAR/PEDONALJA “PASHO HYSI”,
RRUGA AUTOMOBILISTIKE “PASHO HYSI””

Bashkia Skrapar

Nr.	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e ndërt./m ²	Çmimi i ndërt./lekë	Vlera e përgjithshme/lekë	Lloji i dokumentit
1	Fatmira Tahir Xhizdari	1420	4/154	15	43 580	653 703	Vërtetim pronësie
	TOTALI					653 703	